

AUTOSTRADA TIRANË - ELBASAN

Pas një kalvari 7-vjeçar, për shkak të mungesës së studimit gjeologjik dhe një projekti shumë të varfër në detaje teknike, është hapur njëra anë e autostradës Tiranë - Elbasan. Hapja e këtij segmenti ka shkurtuar ndjeshëm distancën mes Tiranës dhe Elbasanit, por gjithashtu eviton trafikun dhe ofron siguri për përdoruesit e kësaj rruge. Ky aks dorëzohet plotësisht për përdorim publik në 17 maj 2019.

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

Në kuadër të Paktit për Universitetin, ministrja Balluku firmosi marrëveshjen e bashkëpunimit me tre Fakultete të Universitetit Politeknik. 32 studentë të ekxelencës tashmë janë pjesë e administratës së MIE dhe institucioneve të varësisë, 240 studentë në vit do të kryejnë praktika mësimore pranë MIE dhe institucioneve të varësisë, ndërsa marrëveshja parashikon edhe thellim të bashkëpunimit sa i takon kërkimeve shkencore, ekspertizës dhe konsulencës.

SIGURIA E URAVE

Një raport për sigurinë e urave në vend është diskutuar në tryezën teknike të organizuar nga MIE. Plotësimi i pasaportës teknike për çdo urë, hartimi dhe miratimi i një metodologjie për inspektimin, hartimi i një plani kombëtar i quajtur "Plani i Shpëtimit" i veprave rrugore të artit mbi 50 vite, janë disa prej gjetjeve të raportit, të hartuar pas inspektimit në terren nga ekspertët e MIE, ARRSH dhe Institutit të Ndërtimit, të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për ndërhyrjet që do të kryen.

MASA NË TERREN PËR SIGURINË E URAVE

Në kuadër të masave për sigurinë e urave, ARRSH së bashku me Drejtorinë e Hekurudhave po hartojnë një projekt për të ndërhyrë në rikonstruksionin e urës së Rogozhinës. Si pasojë e degradimit shumë vjeçar, kjo vepër kishte paraqitur probleme konstruktive në themelet e saj. Për të shmangur çdo rrezik ARRSH vendosi mbylljen e urës për automjetet dhe ndërhyrjen teknike.

PERSONALIZIMI I KARTËS SË LEJEDREJTIMIT

Tashmë personalizim i lejedrejtimit për drejtuesit e automjeteve bëhet i mundur në një kohë më të shpejtë me printerat e rinj të vitit 2019. Sistemi i ri i integruar, nga aplikimi deri tek lëshimi për qytetarët brenda një kohe rekord u bë i mundur pa asnjë kosto apo tarifë shtesë për qytetarët

TESTIM NË HEC 4, KOMAN

U krye testimi i mbrojtjes kundra zjarrit në transformatorin numër 4 në HEC Koman. Sistemi i shuarjes automatike me ujë të pulverizuar të zjarrit në trupin e transformatorëve të fuqisë të agregatëve të prodhimit të energjisë aktivizohet automatikisht në rast detektimi të zjarrit.